



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 6 nëntor 2018.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Sallaku – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës. Por përpara se të fillojmë me rendin e ditës, më lejoni që ne emrin tim, por edhe të gjithë kolegëve të komisionit t'i urojmë ditëlindjen kolegut Çuçi: edhe 100 dhe qofsh ky që je përherë!

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje: miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 6 nëntor 2018. Të gjithë e keni mbi tavolinë procesverbalin e mbledhjes. A ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Çështja e dytë është shqyrtimi nen për nen i projektligjit për buxhetin e vitit 2019. Relator i projektbuxhetit është kolegu Bashkim Fino.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, zoti Fran Brahimi, drejtor dhe Ilir Sallaku specialist.

Po ashtu, në rendin e ditës kemi edhe shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”. Edhe për këtë projektligj relator është kolegu Bashkim Fino.

Zoti Fino, vazhdojmë pa humbur kohë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Neni 1.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, përpara se të kalojmë te nenet që ka projektbuxheti, pra janë rreth 23 nene, të cilat kanë edhe anekset e pasqyrat përkatëse, më duhet t'u them disa gjëra të gjitha institucioneve kushtetuese që erdhën këtu dhe për 2-3 ditë zhvilluam takime e ballafaqime me kërkesat e tyre dhe me Ministrinë e Financave. Ato që kemi miratuar ne gjatë këtyre dy ditëve i kemi pasqyruar në një dokument, të cilin nuk e di nëse jua ka shpërndarë sekretarja apo jo, pra është një draft ku janë kërkesat e institucioneve të miratuara nga ne, për të cilat, në një farë mënyre, kemi rënë pak a shumë dakord edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Kjo nuk do të

thotë se janë zgjidhur 100% për arsyen e vetme se këtë draft, të cilin ju e keni tashmë përpara, do t'ia kalojmë komisionit përgjegjës, që është Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Do të kërkoj që të paktën unë të jem prezent në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë, kur ta kalojë buxhetin nen për nen, që, si avokati juaj, të kërkoj që të gjitha çështjet që janë trajtuar këtu, për të cilat ne kemi ngritur dorën si komision, të miratohen nga Komisioni i Ekonomisë, pra se kemi marrë një gjysmë fjale nga Ministria e Financave. Pasi të lexoj gjithë këtë tabelë që keni para, do t'ia bie shumë shkurt, atëherë ju do të votoni 23 nenet e projektbuxhetit, sepse nenet e projektbuxhetit janë të lidhura me anekset dhe me pasqyrat përkatëse. Në momentin kur ne do të bëjmë këto ndryshime sipas institucioneve kushtetuese, do të thotë të ndryshohen anekset përkatëse të buxhetit, automatikisht edhe nenet e saj.

Më duhet të them se Ministria e Drejtësisë ka kërkuar 643 milionë lekë për Policinë e Burgjeve dhe në zërin e shpenzimeve kapitale 100 milionë. Ne thamë që më 1 prill të vitit që vjen do të rritet paga e Policisë së Burgjeve dhe do të ketë një efekt prej 277 milionë lekësh dhe qoftë ministrja, qoftë Ministria e Financave e kanë në konsideratë dhe këtë zë ata e kërkonin për rritje të pagave. Fakti që qeveria më 1 prill do ta kalojë këtë rritje, ne jemi në rregull me Ministrinë e Drejtësisë për sa kërkoj këtu.

Presidenca nuk paraqiti ndonjë kërkesë, sepse këta të Ministrisë së Financave ishin treguar shumë dorëlëshuar me Presidencën dhe paskan bërë mirë. 86 veta që janë atje, e bëjnë punën shumë mirë, pra as nuk i shtojmë dhe as i pakësojmë gjë.

Prokuroria e Përgjithshme kërkoi shtesë 197 punonjës, nga të cilët 30 oficerë gjyqësorë, 100 sekretarë dhe 5 punonjës për dekriminalizimin, 30 ekspertë dhe 30 nëpunës të ndryshëm. Ne këtu bëmë një diskutim shumë interesant për këtë çështje. Ramë dakord që të shtojmë 30 oficerët e Policisë Gjyqësore, që janë të domosdoshëm, 30 koordinatorët që janë po të domosdoshëm, kemi shtuar edhe 5 punonjës për dekriminalizimin, se është krijuar një sektor i ri, pra kemi shtuar 65 veta me fond page për Prokurorinë e Përgjithshme, duke mos shtuar 100 sekretarët që ata kërkonin për prokurorët. Në fakt, më duhet të them se Ministria e Financave ka qenë korrekte, sepse në projekt kishte sjellë një shtesë prej 50 vetash. Ne si komision kemi shtuar edhe 15 të tjerë. Do t'ia çojmë Komisionit të Ekonomisë shtesën prej 65 vetash.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor është zyra kryesore për të cilin ne kemi përgjegjësi. Ajo kishte kërkuar 83 punonjës shtesë dhe 10 punonjës të administratës gjyqësore pa buxhet shtesë. Komisioni vendosi t'ia japë këta 10 punonjës, sepse kishin kërkuar maksimumin

dhe minimumin, nga 83, në qoftë se marr edhe 10, jam në rregull. 10 punonjës shtesë ne ia kemi miratuar si komision në kuadër të sistemit gjyqësor pa kosto shtesë, sepse, siç u tha këtu edhe nga drejtoresha e ZABGJ-së, fonde për paga kanë, sepse janë shumë vende vakante, të cilat nuk janë realizuar. Këtu bëhej fjalë vetëm për numër dhe jo për çështje fondesh. Ne e kemi miratuar këtë dhjetëshen dhe jemi shumë të kënaqur me buxhetin e vitit 2019 për ZABGJ-në.

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, kthehemi edhe një herë te pika 3, për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor shoh dy punonjës inxhinierë...

**Bashkim Fino** – Jo, është e prokurorisë. Zoti kryetar, prokuroria kishte kërkuar 197 punonjës, 30 oficerë gjyqësorë, 100 sekretarë dhe 5 punonjës për dekriminalizimin, 30 ekspertë dhe 30 nëpunës të ndryshëm dhe 2 punonjës inxhinierë, që shkojnë 197, pra nga 197, ne u shtuam 65, ku shtuam 30 oficerët e Policisë Gjyqësore, 30 koordinatorët, si edhe 5 punonjës për dekriminalizimin. I keni para dhe jua kemi shpjeguar shumë qartë se cilat janë kërkesat dhe ato që ne kemi miratuar.

Avokati i Popullit ka kërkuar 2 milionë lekë shpenzime operative për aktivitete, 2 punonjës shtesë ndihmëskomisionerë, 2 milionë lekë investime për rikonstruksion. Për hir të së vërtetës, ia kemi kaluar edhe vitin e kaluar, duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Komisioni i Ekonomisë nuk ia miratoi këtë kërkesë që ne e miratuam edhe vitin e kaluar dhe po e kalojmë edhe sivjet, 2 milionë lekë shtesë për shpenzime operative për zhvillimin e metodologjive të lidhura me ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kuadër të një projekti danez, i cili ka përfunduar dhe është quajtur një projekt interesant dhe ne kërkojmë ta rimbursojmë, pra t'i japim fonde nga buxheti i shtetit për ta vazhduar.

Mendoj se këtë dymilionëshin e kemi kaluar edhe vitin e kaluar. I propozojmë Komisionit të Ekonomisë për një shtesë prej 2 milionë lekësh shpenzime operative.

Gjykata Kushtetuese kërkoj 10 punonjës shtesë dhe 10 milionë lekë për investime për rikonstruksionin e godinës. Komisioni mendon se Gjykata Kushtetuese me 62 persona është më se e mjaftueshme me organikë dhe detyra. Ju them se struktura, zoti kryetar, nga 54 veta në vitin 2017 është shtuar në 62 veta në vitin 2018. Unë nuk arrij ta kuptoj që të shtohet me 8 veta nga viti 2017 në vitin 2018 dhe të kërkojë edhe 10 vetë të tjerë shtesë për vitin 2019! Kjo më duket absurde! Prandaj ne nuk e kemi marrë në konsideratë këtë shtesë, sepse ne ua kemi bërë një shtesë të konsiderueshme prej 8 vetash vitin e kaluar dhe nuk mund të bëjmë çdo vit shtesë të numrit të punonjësve.

Për sa i përket godinës, godina është e Kuvendit, nuk mund të bëjmë ndarje fondesh për investime të godinës. Në kuadër të investimeve që do të bëjë Kuvendi i Shqipërisë, do të bëhet edhe godina e Gjykatës Kushtetuese, edhe pse Gjykata Kushtetuese nuk funksion, ka edhe probleme të tjera, që ka marrë vendime, të cilat jua kam thënë në mbledhje, po e them sot dhe do ta them në Komisionin e Ekonomisë, do ta them edhe në seancë plenare, janë në konflikt të pastër interesi, sepse ka caktuar pagat e veta, domethënë pagën e duam kaq. Pra, “meqë jemi Gjykatë Kushtetuese, ne e vendosim pagën kaq dhe nuk ka çfarë bën as Ministria e Financave, as qeveria”. Thua se ata janë republikë më vete! Edhe ne si Kuvend mund të themi se duam kaq shpenzime, i duam pagat kaq dhe Ministria e Financave është e detyruar ta respektojë vendimmarrjen tonë, se në fund të fundit jemi Republikë Parlamentare. Ky është një diskutim tjetër. Në rastin konkret ne nuk ia shtojmë 10 punonjës, sepse i kemi shtuar tetë punonjës vitin e kaluar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe ti ke votuar. Ke qenë prezent këtu kur e kemi bërë diskutimin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të mbaroj, mund të bësh pyetje. Meqë më ndërhyre në mes të diskutimit dhe është hera e dytë që ndërhyr, po të them se ne diskutimet i kemi bërë: institucioni kushtetues-Ministria e Financave dhe ju keni qenë këtu prezentë, në fund të çdo diskutimi kemi thënë që marrim në konsideratë këtë gjë dhe nuk marrim në konsideratë këtë gjë. Atë që kemi thënë në fund të çdo diskutimi keni qenë prezentë të gjithë këtu kur e kemi miratuar. Atë që e kemi miratuar pjesëzë-pjesëzë në këto dy-tri ditë unë i kam përmbledhur në një pasqyrë, të cilën po trajtoj tani në komision dhe në fund ti e unë kemi mundësinë ta miratojmë ose ta hedhim poshtë. Të gjitha këto do të shkojnë në Komisionin e Ekonomisë, se ai është komision përgjegjës, ne nuk vendosim gjë. Ne themi se nuk ia vlen të shtohen 10 punonjës. Në qoftë se Komisioni i Ekonomisë ia jep, le t’ia japë. Unë nuk kam asnjë vërejtje. Ky është sqarimi që doja të bëja. Nuk e kam personale, se nuk i jap unë. Unë jam njësoj si ty. Sot kam vetëm të drejtën e zërit, pra po flas meqë kam bërë materialin, kurse votën e kemi njësoj, një votë ti, një votë unë. Madje, mund të kesh më shumë mundësi ti, se mund të bëni... Ja do të flas më poshtë për lobingun që keni bërë ju me këtë Shkollën e Magjistraturës.

Vazhdojmë me ILDKPKI-në. Kërkon shtesë në zërin e shpenzimeve prej 4 milionë lekësh, zoti kryetar, për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të deklarimit *online*. Komisioni, kur e diskutuam këtu, e miratoi vlerën prej 4 milionë lekësh në zërin “Shpenzime operative për

mirëmbajtjen e sistemit *online* të deklarimit të interesave private”, i cili po realizohet me fonde të USAID-it dhe KE-së. Kështu, ne jemi të detyruar t’ua japim këtë fond shtesë prej 4 milionë lekësh.

Ministria e Brendshme, gjendja civile, prefektura nuk patën probleme, por ishin të kënaqur me buxhetin që u kishte miratuar qeveria. Do të flas në fund për çështjen e buxhetit vendor.

Autoriteti për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Ju e keni pasqyrën përpara dhe nuk dua ta lexoj. Komisioni dha mendim pozitiv për akordimin e fondit të nevojshëm në zërin “Paga dhe sigurime shoqërore për 10 punonjës”, të cilat janë miratuar me vendim të Kuvendit nr. 95/2016. Zoti kryetar, dua t’ju kujtoj se struktura e këtij Autoriteti është miratuar në vitin 2016 për 60 punonjës, ndërkohë fondi i pagave dhe punonjësit e miratuar, në fakt, janë 30, dhe kemi thënë që këtë numër do ta shtojmë çdo vit. Për këtë vit i kemi shtuar 10, pra nga 30, bëhen 40, të cilët do të keni edhe fondin e pagës.

Shtesë fondi për investime 23 milionë lekë për rikonstruksionin dhe kthimin në gjendje pune të zyrave të arkivit. Kjo është një shtesë minimale dhe, natyrisht, duhet të rregullohet. Këto janë dy shtesat që ne dëshirojmë t’ia japim Autoritetit Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pra shtimin e 10 punonjësve, pasi struktura është miratuar, dhe 23 milionë lekë për rikonstruksionin dhe kthimin në gjendje punë të zyrës së arkivit. Ka bërë shumë kërkesa, por ne për këto dy kërkesa kemi rënë dakord. Nuk dua t’i lexoj, se i keni përpara.

KQZ-ja është në një vit zgjedhor dhe ka kërkuar 27 milionë lekë për rikonstruksionin dhe përgatitjen e magazinës së materialeve në Lundër, e cila është një magazinë që i është bërë kalim kapitali nga qeveria shqiptare, por nuk është në gjendje të mirë dhe ne e morëm në konsideratë kërkesën që bëri kryetari i KQZ-së dhe i propozojmë Komisionit të Ekonomisë të livrojë 27 milionë lekë për rikonstruksionin e kësaj magazine për mbajtjen e materialeve zgjedhore.

Shkolla e Magjistraturës ka kërkuar 3 punonjës dhe Ministria e Financave ia ka marrë të tre në konsideratë dhe nuk kemi pse e shtojmë fare këtu, si dhe ka kërkuar edhe blerjen e një autoveture, pra tip furgon. Natyrisht, unë si relator kam qenë kundër, por dëshirat tuaja, dhe këtu është lobimi juaj tani, jo imi, kanë qenë që ta shënojmë që t’i japim 5 milionë lekë, pra t’ia kërkojmë Komisionit të Ekonomisë për të blerë një furgon për nevojat e institucionit. Pavarësisht se unë personalisht jam kundër, por në momentin që ju të vendosini për këtë, unë jam i detyruar ta shënoj në relacion. Alket, nuk jam gabim, apo jo?! Unë jam korrekt. Edhe për atë që unë kam qenë kundër kur më ke thënë ti, bashkë me kryetarin që duhet ta bëjmë, unë e kam shënuar. Personalisht jam absolutisht kundër, sepse asnjë institucioni kushtetues nuk i kemi dhënë fonde për blerje

makinash, gjithsesi këtu është shënuar dhe ne do t'ia dërgojmë Komisionit të Ekonomisë. Shpresoj që Komisioni të më dëgjojë mua dhe jo të gjithë anëtarët.

Komisioneri për të Drejtat e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka shumë kërkesa, të cilat ju i keni para dhe unë nuk dua t'i lexoj, por ajo që ne miratuar bashkërisht dhe thamë që duam ta ndihmojmë për t'ia dërguar Komisionit të Ekonomisë është akordimi i fondit në zërin paga, sigurime shoqërore për tre punonjës shtesë dhe shtesë fondi me shumën 15 milionë lekë për rikonstruksionin e një salle dhe blerje pajisesh të asaj salle, e cila u shërben tri institucioneve. Ajo është një godinë që është rregulluar para disa vjetësh dhe ka mbetur vetëm salla për ta rregulluar dhe ia vlen barra qiranë për ta rregulluar atë sallë, sepse u shërben tri institucioneve, edhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit, edhe Komisionerit të Shërbimit Civil, edhe Avokatit të Shtetit, të cilëve do u vihet në ndihmë kjo sallë. Ata kanë kërkuar 20 milionë lekë, ne menduam 15 milionë lekë për investime dhe blerje pajisjesh.

Komisioneri për Shërbimin Civil ka kërkuar 5 milionë lekë për shpenzime monitorimi për vitin zgjedhor dhe për rritje të kategorisë së pagave për dy pozicione pune e të tjera dhe 3 milionë lekë për blerje mjete, që nuk ia kemi miratuar. Kemi menduar t'i japim 4 milionë lekë shtesë për shpenzime për vitin zgjedhor për kontrollin e administratës publike gjatë fushatës zgjedhore dhe 2 milionë lekë shtesë për shpenzime të tjera operative.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kërkuar asgjë, vetëm të respektohet vendimi i parlamentit që ne kemi miratuar në tetor të vitit 2018, ku kemi ndryshuar strukturën. Nga vendimi nr. 88/2018, që ne kemi ndryshuar strukturën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Financave duhet të reflektojë numrin e punonjësve dhe fondin e pagave të strukturës që ka miratuar parlamenti dhe është e detyruar ta respektojë vendimin për t'i bërë efektive për vitin 2019. Në qoftë se respektohet vendimi i parlamentit, ai nuk ka probleme me shtesat.

Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit mbetet siç është, nuk ka asnjë lloj problemi.

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë është rënë dakord të plotësohet me fond page sipas kontigjencës që ka Ministria e Financave. Në fillim të vitit 2019 do të kenë ndryshim të pagave, sidomos për inspektorët e kontrollit. Alket, ti ke gjithë këtë ngarkesë të madhe politike dhe inspektorët marrin pagë më shumë sesa ti dhe më shumë se ai që drejton KLD-në, që është Presidenti i Republikës. Janë 16 inspektorë dhe unë sugjeroj që më mirë të jetë një inspektor dhe

disa kryetarë komisioni. Kryetari, që është Presidenti, merr dy herë më pak sesa inspektorët me fondin e pagave të miratuara sipas ligjit që ju keni miratuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur e përballon ti atje, unë nuk e kam problem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, nuk ka pretendime.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioni i Posaçëm i Apelit dhe Komisioneri Publik janë tri komisione, për të cilat ju e dini që para dy muajsh, për shkak të ngarkesës që ata paraqitën, ne kemi bërë një diskutim të gjerë dhe i kemi ndihmuar në ndryshimin e strukturës që ata kanë paraqitur. Ne, me ndihmën e Kryeministrit dhe të qeverisë, dhamë dakordësinë për të ndryshuar strukturën e tyre. Sot ato struktura janë pothuajse efektive dhe këta drejtues i kanë marrë njerëzit në punë. Kemi shtuar vende pune fonde, kemi ndryshuar vlerësimin e kategorive të pagave dhe në të tria rastet Ministria e Financave ka respektuar vendimin që ka marrë Kuvendi, duke e paraqitur në buxhetin e vitit 2019. Të vetmen shtesë e kemi bërë te Kolegji i Posaçëm i Apelit, me një shtesë prej 12,7 milionë lekësh, e cila është shtesë fondi në zërin investime në masën për të blerë një skaner për kontroll për detektor, i cili është i domosdoshëm. Ne nuk jemi kursyer për këto institucione, por kemi dhënë dakordësinë. Këtë shifër prej 12,7 milionë lekësh do t'ia kalojmë Komisionit të Ekonomisë, që t'ia kalojnë Kolegjit të Posaçëm të Apelit si investim për të blerë detektorin. Të gjitha fondet e këtyre tri institucioneve janë në rregull.

Së fundi, dua të shtoj dy gjëra.

Së pari, në ligjet organike që kemi kaluar u kërkua nga të gjitha institucionet, si: Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm, KPK-ja, gjykatat, Avokati i Popullit e të tjera me radhë, bazuar në kërkesën e Komisionit të Pavarur, që t'i propozojnë Komisionit të Ekonomisë të parashikojë një fond të posaçëm për sigurimin e jetës dhe shëndetit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit, bazuar në parashikimin e nenit 25 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta, personeli i institucioneve të rivlerësimit, si dhe personeli mbështetës i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtje të veçantë. Kjo është shkruar në ligj. Unë e kam për detyrë ta them, sepse jemi komision përgjegjës dhe ata e kërkuan këtu zyrtarisht, por, po të më pyesni personalisht do të thosha që është e tepërt



për një arsye shumë të thjeshtë, qeveria u ka vënë në dispozicion truproja dhe makina, që presupozohet se është personel mbështetës për të ruajtur jetën e tyre. Nuk e kuptoj që jeta e tyre ruhet duke paguar sigurim jete. Gjithsesi, ne e kemi vendosur si pikë dhe do t'ia dërgojmë Komisionit të Ekonomisë, pastaj nëse Ministria e Financave pranon të japë edhe fonde të tjera, unë nuk jam kundër, por unë jam i detyruar ta trajtoj, sepse jemi komision përgjegjës.

Pika e dytë ka të bëjë me organet e pushtetit vendor. Natyrisht, ne kemi pasur një diskutim me Franin, i cili merret me këtë punë. Ka një formulë të ndarjes së planit të pakushtëzuar, e bërë me USAID-in, e cila ka dy vjet që është konsoliduar, por më duhet ta them që në kuadrin e ardhjes së turistëve dhe të shifrave mbresëlënëse të këtij viti, ku mbi 2 milionë e gjysmë turisë kanë ardhur në Shqipëri, kam përshtypjen se ndoshta duhet riparë formula dhe ne t'i propozojmë Komisionit të Ekonomisë nëse është në gjendje që ta rishikojë ose jo. Komisioni i kërkon Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të shikojë mundësinë të përlogarisë transfertën e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore dhe të marrë në konsideratë përcaktimin e koeficienteve konvertues për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të turistëve vendas dhe të huaj në bashkitë që mbulojnë territorin e vijës bregdetare, sidomos në bashkitë që kanë në juridiksion zonat dhe objektet e mbrojtura nga UNESCO, siç është Berati dhe Gjirokastra, pse jo edhe Krujën, Tropojën, Korçën e të tjerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është e keqja, sepse ju nuk dëgjoni, por unë thashë për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të turistëve vendas dhe të huaj në bashkitë që mbulojnë territorin e vijës bregdetare. Nëse Saranda nuk futet në territor të vijës bregdetare, nuk fiton gjë, por unë e di që futet, sepse laget nga deti. Përveç këtyre, vijave që lagen nga detet apo liqenet, kemi futur edhe dy qytete, që janë pasuri e UNESCO-s, Gjirokastra dhe Berati, pse jo edhe Tropoja dhe Kruja si vende turistike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ti mund t'ua bësh qejfin dhe të fusësh të gjitha qytetet, por nuk e vendosni ju, por këta të tjerët.

**Bashkim Fino** – Të gjitha bashkitë, për hir të së vërtetës, kanë shpenzime dhe bëjnë shërbime, por shërbimet që bën Bashkia e Sarandës në 4 muajt e verës, nuk mund t'i bëjë Bashkia e Cërrikut, apo e Maliqit. Pse? Sepse atje, në një moment të caktuar shkon 5-fishi i popullsisë dhe bashkia duhet të pastrojë kazanët e plehrave 2-3 herë, do të shpenzojë me shumë dhe do të harxhojë

më shumë. Prandaj duhet llogaritur një koeficient për të gjithë këta njerëz që vijnë dhe shfrytëzojnë bregdetin tonë dhe vendet e bukura të UNESCO-s. Në qoftë se ne i propozojmë Komisionit të Ekonomisë dhe e merr në konsideratë një gjë të tillë, pavarësisht se ne kemi një nënkomision të pushtetit lokal, dhe shikon mundësinë të rrisë transfertën e pakushtëzuar për këto bashki, unë mendoj se është diçka pozitive. Gjithsesi, ngelet në diskutim të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Kjo ishte për sa i përket buxhetit.

Ju faleminderit që kishit një vëmendje të jashtëzakonshme!

Te ligji për sistemin e taksave vendore, të cilin e diskutuam dhe e miratuam me Ministrinë e Financave nuk ka asnjë problem, por, kur të kalojmë te diskutimi nen për nen, ka dy gjëra teknike, por në parim jemi dakord me të gjitha çështjet.

Në qoftë se të gjithë biem dakord me tabelën që kemi para, atëherë ne jemi gati të miratojmë nen për nen projektbuxhetin, sipas tabelës që ne do t'i paraqesim Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Meqenëse ne jemi komision përgjegjës për shumë institucione kushtetuese, ne duhet t'i paraqesim Komisionit të Ekonomisë këto sugjerime.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fran, ajo që doni të thoni ju është sugjerim, shpjegimin e bëri zoti Fino.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di se çfarë do të thuash ti, që formula është unike dhe e keni dakordësuar me Bankën Botërore. Është ajo që keni thënë vjet, por për efekt regjistrimi mund ta përsërisni.

**Fran Brahimi** - Unë dua të sqaroj se sistemi i financimit të pushtetit vendor ka dy shtylla kryesore: formulën dhe taksat. Qëllimi kryesor i sistemit të financimit të pushtetit vendor është, së pari, të sigurojë ushtrimin e funksioneve të tij në të gjithë territorin dhe, së dyti, kur ka taksa vendore më shumë dhe ka zhvillim më shumë të rritet kualiteti dhe volumi i shërbimeve publike. Formula është instrumenti kryesor që siguron ushtrimin e funksioneve ligjore në të gjithë territorin, që do të thotë se formula nuk ka sens zhvillimor, por merr në konsideratë vetëm shpërndarjen e burimeve. Domethënë, bashkitë që janë më shumë se 20, të cilat nuk kanë mundësi të sigurojnë të ardhura nga taksat e veta, sepse përveç këtyre kanë edhe probleme sociale, u jepet shumë më shumë transfertë që të ushtrojnë funksionet e tyre. Pra, presupozohet se bashkitë, të cilat janë në vijën bregdetare, diferencën e bëjnë tek taksat. Ato mbledhin shumë herë më shumë taksa, që i marrin

për veten e tyre dhe nuk u llogariten askund, dhe i ushtrojnë funksionet më mirë sesa dikush tjetër. Formula këtë princip ka, madje është parim i financave publike, në çdo vend, që të sigurohet rishpërndarja e burimeve. Për shembull, bashkitë Bulqizë, Memaliaj, apo Fushë Arrëz nuk i kanë mundësitë që të ushtrojnë funksionet e tyre dhe, nëse ne do t'i ndihmojmë dhe t'u çojmë para aty ku ka para më shumë...

Së dyti, te ligji i financave të vetëqeverisjes vendore, meqenëse kriteret janë të qëndrueshme dhe do të jenë gjithmonë, ne i kemi theksuar ato, janë aty dhe nuk ka fleksibilitet që të shtohen dhe të hiqen kriteret.

Së treti, është një parim kushtetues, që ju mund ta dini shumë mirë, që çdo iniciativë që merret për të ndryshuar duhet konsultuar me pushtetin vendor. Qeveria ka mbyllur fazën e diskutimeve dhe kjo paketë është konsultuar dhe dakordësuar me të gjithë pushtetin vendor.

**Ulsi Manja** – Nuk i zgjidhim në komision këto gjëra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kemi 6 buxhete, që formula është e konsultuar, e miratuar dhe nuk ndryshon.

A jeni dakord me tabelën që sapo relatoi kolegu Fino?

**Bashkim Fino** – Te tabela e Ministrisë së Drejtësisë e kam rakorduar me Ministrinë e Financave dhe harrova ta thosha. Tabelat i keni, ku nuk është Ministria e Drejtësisë, do të hapet një program i veçantë për ndihmën juridike nga Ministria e Financave. Pra, në faqen e parë te tabela e Ministrisë së Drejtësisë do të shënohet: “Të hapet një program i veçantë për ndihmën juridike” te Ministria e Drejtësisë”, sepse Ministria e Financave e ka marrë përsipër.

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, këto i kemi votuar.

**Alket Hyseni** – Dua t'i bëj një shpjegim tabelës.

**Ulsi Manja** – Cilës pikë? Tabelën e kemi votuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tabela është votuar, por gjithsesi bëjeni një koment.

**Alket Hyseni** - Së pari, falënderoj punën e kolegut Fino, një punë voluminoze, sepse nuk është e lehtë të diskutosh në detaje elementet e buxhetit të shtetit për institucionet që komisioni ynë ka në varësi, sepse për ato jemi komision përgjegjës. Vërtet, në fund të fundit, është Komisioni i Ekonomisë që do të bëjë një miratim përfundimtar për t'ia përcjellë seancës, por mendoj se duhet të sqarojmë pozitën e Komisionit të Ligjeve. Për këto institucione që kemi përgjegjësi, rekomandimi ynë duhet të jetë rekomandim detyrues për komisionin tjetër, sepse këtu nuk

diskutojmë as për interesat tona të ngushta, as për ndonjë qëllim tjetër, i vetmi synim është që këto institucione të sigurojnë vijimësinë e tyre. Në këtë fokus, kërkesat e mia personale, në raste të caktuara kanë synuar që institucionet së paku të kenë kushtet minimale për funksionimin e tyre.

Më lejoni të bëj një sqarim për opinion publik.

Ne e dimë që nga institucionet kërkesat për fonde janë të shumta. Relatori së bashku me ne ka gjykuar se me këto fonde dhe këto shtesa që ne u dhamë sot mund të kryhet më së miri funksioni i tyre kushtetues.

Nga ana tjetër, kemi thënë që jemi të hapur në rast se (ashtu thamë edhe vitin e kaluar dhe në mes të vitit, kur ripamë buxhetin, dhe tani) ndonjë nga institucionet e ka të domosdoshme mbështetjen me fonde të tjera, kemi gjetur dhe mirëkuptimin e Ministrisë së Financave për ta ridiskutuar atë. Por ajo që ne, si deputetë, kërkojmë, përveçse jemi anëtarë të Komisionit të Ligjeve dhe që na jepet mundësia këtu të flasim edhe në cilësinë e deputetit për zonat tona, është fakti se asnjë kërkesë jona nuk duhet neglizhuar, asnjë formulë nuk është e mbyllur, sepse formulat i bëjmë ne, formulat i bën Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Në fund të fundit, Ministria e Financave mbështet me votë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Në qoftë se ne i kërkojmë, me të drejtë, nëpërmjet relatorit që për disa zona të caktuara të rishikohet formula e shpërndarjes së granteve, këtë e themi, sepse gjatë sezonit turistik në këto qytete pesëfishohet numri i popullsisë. Për shembull, në Sarandë kanë kaluar gati 1,1 milionë turistë, të cilëve duhet t'u shërbehet me pastrim, të cilët duhet të furnizohen me uji të pijshëm, kanalizimet të jenë efeciente, sistemi rrugor dhe ndriçues duhet të përmirësohet dhe t'u shërbejë. Këto nuk bëhen me fjalë, këto bëhen me fakte.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, mbaroni mendimin tuaj!

**Alket Hyseni** – Me çfarë parash duhet t'u shërbehet këtyre kur taksat ua merr përsëri buxhetit qendror? U keni lënë një pjesë taksave, aq sa është territori i atij vendi. Rishikojeni formulën, sepse nuk ka formulë të ngurtë. Ministri thotë “jam i hapur ta diskutojmë”, kurse ti vjen këtu, dhe thua nuk “jam i hapur ta diskutojë”. Ne nuk i duam për vete, nuk po kërkojmë as rrogat tona. Me të drejtë relatori thotë se këtu ka mijëra punonjës që paguhen shumë më shumë se deputetët dhe ne nuk po kërkojmë gjë. Ne po kërkojmë që zonat tona të mbështeten, që institucionet që kemi në përgjegjësi të mbështeten. Kaq kemi kërkuar. Në qoftë se kërkesat tona janë të pamundura, duhet të kuptoni pozitën tonë, ashtu siç ne kuptojmë edhe mundësitë e buxhetit të shtetit, që janë të kufizuara.

Zoti kryetar, këtë sqarim desha të bëja dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj, që përveç asaj që ne përfaqësojmë në këtë komision, kemi edhe përgjegjësi për zonat tona elektorale. Në këtë komision, ku jemi të anëtarësuar, do të paraqesim dhe objeksionet.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Urdhëroni, zoti Çuçi!

**Bledar Çuçi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, për atë që po diskutojmë më mirë se unë dhe zoti Fino, që jemi marrë gjerësisht me këtë punë, nuk mund të ketë ekspertë në këtë tavolinë. Kështu që, dua të jap dy-tre konsiderata për çështjen e transfertës së pakushtëzuar.

Kam një pyetje për zotin Brahimi dhe për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Jam shumë dakord me atë që tha zoti Fran, sepse formula ka ardhur në një pikë që mendoj se është në fazën e konsolidimit të plotë për ndarjen e transfertës të pakushtëzuar për qeverisjen vendore. Jam dakord edhe me argumentin se nuk kanë nevojë që bashkitë që kanë asete natyrore të ndryshme nga bashki të tjera, dhe që ju mundësojnë bërjen apo thithjen e turizmit në masë të madhe siç janë bashkitë bregdetare, vetë instrumenti apo vetë formula e decentralizimit, që tashmë e kemi të instaluar si pjesë e buxhetit u mundëson atyre përmbushjen e gjithë funksioneve dhe kryerjen e shërbimeve edhe në faza kur rritet në mënyrë të konsiderueshme numri i popullsisë për shkak të turizmit. Ashtu siç e tha përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, ata kanë më shumë turistë, por kanë edhe më shumë të ardhura. Pikërisht, decentralizimi ka bërë këtë gjë, që duke aplikuar taksat vendore, ata shëndoshin buxhetet e tyre për t'i shfrytëzuar për qëllimet krejtësisht të pandikuara dhe të pavarura nga qeverisja vendore. Ky është thelbi i decentralizimit. Mendoj se ata sot i kanë të gjitha mundësitë për ta realizuar këtë gjë.

Ajo që unë nuk bie dakord me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, dhe, në fakt, është në relacion dhe dua një sqarim, pastaj hajde të debatojmë, lidhet me disa funksione dhe shërbime, që gjatë këtyre viteve të fundit i kemi transferuar në pushtetin vendor dhe i kemi mbuluar me shumën përkatëse për shërbimin, siç i kishte pushteti qendror ia kemi çuar pushtetit vendor. I kemi pasur pjesë të formulës, këtu po lexoj relacionin që na keni sjellë bashkë me buxhetin, ku thoni: “Para vitit 2016 fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe bashkitë në listën UNESCO inkorporoheshit në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive”.

Unë dua të merrem vetëm me UNESCO, sepse për konviktet dhe shërbimet sociale jemi të qartë. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, ajo që po themi

që po konsolidohet, dhe jam dakord që po shkon drejt konsolidimit dhe nuk duhet prekur ose duhet prekur sa më pak, duhet ndërhyrë sa më pak aty, pra me hyrjen e formulës së re të ndarjes, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës dhe ndahen me formulë. Duke filluar nga viti 2016 këto fonde paraqiten vetëm te bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqiten në tabelën numër 3.

Dua të merrem vetëm me qytetet që janë pjesë e UNESCO-s, sepse kanë një specifikë krejt ndryshe nga çdo bashki tjetër. Pra, është detyrim që të mbash një qytet të UNESCO-s, ti si shtet, si bashki, e ke detyrim nga një marrëveshje të qenurit pjesë e UNESCO-s. Ashtu siç unë e lexoj, nuk është në formulë që ta përfitojë, të ketë një koeficiencë specifik Berati dhe Gjirokastra, por mbasi aplikohet formula, duhet të ketë një tabelë të veçantë, një kolonë të veçantë, ku të thuhet: “Për bashkitë që janë pjesë e UNESCO-s duhet të ketë një fond shtesë mbi fondin që përfiton si rezultat i ndarjes së transfertës së pakushtëzuar”. Këtë e thoni ju në relacion dhe unë jam shumë dakord me relacionin. Por në tabelën që e shoqëron dhe është për këtë qëllim nuk e shikoj shtesë. Këtu është pyetja ime, ju në relacion argumentin e keni, e keni shumë të drejtë dhe në tabelën përfundimtare, ku i referoheni, nuk është kolona kur janë shtesat e fondeve për bashkitë të UNESCO-s.

Ju lutem, qëndrojeni argumentit, vendoseni në mënyrë specifike shtesën për Gjirokastrën dhe Beratin, sepse mirëmbajtja e dy qyteteve të UNESCO-s është detyrim. Pavarësisht se shkojnë apo nuk shkojnë turistë në Berat dhe në Gjirokastrë, Gjirokastra dhe Berati...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kuptojnë sa e rëndësishme është që të shikohen në mënyrë specifike këto dy qytete, sepse nuk është mirëmbajtje rutinë, apo më mirë të themi mirëmbajtja rutinë e Beratit dhe Gjirokastrës është krejt ndryshe nga mirëmbajtja rutinë, qoftë edhe e Tiranës që është kryeqytetet.

Dua të më saktësoni: ku janë shtesat për dy bashkitë, Berat dhe Gjirokastrë, në transfertën e pakushtëzuar për këto dy bashki, për qëllim të faktit apo në funksion të faktit që këto të dyja në bashki të UNESCO-s, ashtu siç thoni ju vetë në relacion?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

Zoti Fino, duke qenë se debati që sapo u bë nga kolegu Hyseni dhe zoti Çuçi lidhet me nenin 16 të projektligjit të buxhetit, unë të sugjeroj që, si relator të vazhdojmë pa humbur kohë me

shqyrtimin dhe miratimin nen për nen dhe kur të vijmë te neni 16 të kemi edhe përgjigjen për zotin Çuçi.

Është një nen në ligjin e buxhetit, që bën fjalë në transfertën e pakushtëzuar dhe formulën e shpërndarjes. Ndaj edhe përgjigjen për të dy kolegët duhet ta japin te neni 16.

Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen dhe më pas në nene të caktuara, ku ka problematika, kolegët mund të marrin fjalën dhe të ndërhyjnë.

Neni 1.

**Bashkim Fino** – I gjithë diskutimi që u bë këtu nuk ka të bëjë (sepse ky ishte keqkuptimi që kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave), me faktin që ne jemi kundër ndarjes së transeftrës së pakushtëzuar apo formulës. Ajo është një formulë e konsoliduar dhe po ecën, ashtu siç e tha dhe zoti Çuçi. Ajo që ne kërkojmë dhe që diskutojmë për Komisionin e Ekonomisë, në kuadrin e një prurjeje të jashtëzakonshme për të gjithë turistëve, po propozojmë dhe po themi, a ka mundësi që Komisioni i Ekonomisë ta shikoj mundësinë, por jo zoti Fran të heqim nga një bashki, siç morët ju shembull Bulqizën apo bashki të tjera dhe t’ia japësh bashkisë tjetër. Absolutisht jo. Ne pretendojmë ta shtojmë transfertën e pakushtëzuar. Ne nuk themi se kjo ndarje që është bërë sipas kësaj formule ka vërejtje. Jo, kjo është në rregull, sepse është një formulë e konsoliduar, por edhe për disa elemente të tjera shtesë, pra ato për numrin e turistëve dhe ato që argumentoi me të drejtë zoti Çuçi, sipas relacionit që keni paraqitur ju për qytetet e UNESCO-s, që është detyrim, a mundet që në transeftrën e pakushtëzuar të ketë shtesë? Por jo t’ia heqësh një bashkie dhe t’ia vësh një tjetër, absolutisht jo, sepse pastaj ajo prek të gjithë skemën e formulës dhe nuk ia vlen të preket. Ndërsa propozimi ynë është, a ka mundësi që në buxhet, këtë mund ta shikojë edhe Ministria e Financave në një linjë të caktuar. Pra, linja bregdetare dhe disa qytete, të paktën dy janë të mbrojtura nga UNESCO, mund të shikohen me përparësi, në mënyrë që të kenë një shtesë për transfertën pakushtëzuar, pa e ngacmuar atë transfertë që ju e keni paraqitur në projektbuxhet? Ky është thelbi i diskutimit tonë.

Kjo duhet të kuptohet, pasi kur të shkojmë te neni 16 nuk do të kemi çfarë t’i ndryshojë këtij neni. Pra, ne jemi dakord me atë nen, por i propozojmë ministrisë dhe Komisionit të Ekonomisë që ta shikojnë këtë gjë dhe të nxjerrin të ardhurat në një vend tjetër, në mënyrë që këto të ardhura t’i shpërndajnë tek transferua e pakushtëzuar. Pra, duhet të kenë parasysh propozimin e Komisionit të Ligjeve, që këto 10 milionë t’ua shpërndajnë këtyre qyteteve. A jemi dakord? Këtu

nuk po futem tek ajo tjetra, mos u keqkuptoni, sepse atë gjë e kemi bërë vetë ne bashkërisht. Unë jam dakord që të fillojmë me nenin 1.

**Ulsi Manja** – Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim ? Nuk ka .

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë”.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, këtu do të them të gjitha reflektimet e materialit që ne kam paraqitur.

Te neni 11 nuk mund të mbetet numri 82 mijë e 22 veta, por nëse Komisioni i Ekonomisë e merr në konsideratë, atëherë mund ta shtojë numrin, për shembull numri të shkojë 82 mijë e 70 veta. Kjo mund të bëhet sipas reflektimeve që kemi bërë ne, sepse nëse do të ngremë dorën ne për 82 mijë, atëherë...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Atëherë, vazhdojmë.



Neni 11, me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Ligjeve për Komisionin e Ekonomisë, që të reflektohen ndryshimet që ne kemi bërë në numrin e përgjithshëm të punonjësve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Paga e Presidentit të Republikës”

**Bashkim Fino** – Neni 12 është neni më i diskutuar. Unë nuk kam lidhje me emrin e përveçëm të Presidentit, por bëhet fjalë për institucionin. Ne çdo vit, siç e kam thënë, kalojmë në buxhet pagën e Presidentit të Republikës. Ne e kalojmë këtë si një pikë e kuqe, ku mbi bazën e kësaj bëhet e gjithë tabela e pagave për të gjithë nëpunësit e shtetit shqiptar, duke vazhduar Kryeministrin e vendit, me Kryetarin e Kuvendit, ministrat, deputetët, gjyqtarët, kryetarët e bashkive, prefektët e kështu me radhë sipas hierarkisë së vendit. Rasti konkret që ne po e diskutojmë dhe po e kalojmë këtu (unë ia kam thënë ministrit të Financave, po e them këtu, por do ta them edhe në Komisionin e Ekonomisë) ka një disproporcion të madh. Paga e Presidentit të Republikës me pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët kanë marrë një vendim nga Gjykata Kushtetuese, ku thotë se, pavarësisht nëse e kanë kaluar apo jo vetingun, nga 1 janari të gjithë do të marrin pagat e larta, ka një disproporcion. Unë e kam këtu evidencën dhe do t’jua jap si një tregues të gjithë juve që ta keni parasysh se si janë pagat e gjyqtarëve dhe si do të bëhen në datën 1 janar. Këtu bëhet fjalë për të gjithë gjyqtarët, duke filluar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, kryetari i Gjykatës Administrative Tiranë, kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda, kryetari Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kryetarët e gjykatave të rretheve, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e Apelit, gjyqtarët e Krimeve të Rënda, gjyqtarët e rretheve e të tjerë. Pra, kjo është tabela e pagave që është në disproporcion me nenin 12. Cila është zgjidhja?

Ka dy zgjidhje: së pari, duhet urgjentisht që qeveria të ngrejë një grup ndërministror dhe të bëjë një skanim të pagave të punonjësve të Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga paga e Presidentit të Republikës, që miratohet në buxhet, dhe vazhdon me të gjithë të tjerët. Unë nuk jam xheloz që të preken pagat e këtyre që i kemi kaluar me një ligj organik dhe jam dakord që ta marrin pagën e lartë, por në funksion të këtyre pagave, që tashmë bëhen efektive me kontigjencën që Ministria e Financave ka bërë, duhet të respektojmë edhe institucionet e shtetit tonë. Ne jemi republikë parlamentare dhe nuk mund të lejojmë që një gjyqtar i thjeshtë në Veri, në Jug apo në Tiranë të marrë dyfishin e pagës që merr Presidenti i Republikës, kushdo qoftë president; të marrë

dyfishin e pagës që merr Kryeministri vendit apo dyfishin e pagës që merr Kryetari i Kuvendit, nuk po llogaris deputetët, sepse do të kemi konflikt interesi. Kjo mua më duket pa logjikë. Dua t'ju them diçka shumë interesante në diskutimet që kemi bërë në Kuvend dhe do të mahniteni, sepse jam duke u konsultuar dhe po shikoj se çfarë po bëhet me OJF-të e famshme.

Zoti kryetar, a kemi ne një protokoll shteti? Po, e kemi. Cili është protokollin e shtetit? Kur ka një ceremoni në rreshtin e parë del Presidenti i Republikës (të paktën unë kështu e di edhe për shkak të eksperiencës 25-vjeçare në politikë, por kam qenë edhe Kryeministër), më pas dalin Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ministrat, deputetët, prefekti e kështu me radhë. Tani ne do të kemi festat e nëntorit, Festën e Flamurit dhe Festën të Çlirimit dhe në Varrezat Dëshmorëve do të ketë një protokoll, por nëse ne do të marrim si protokoll nenin 12, atëherë ky protokoll duhet të ndryshojë. Si duhet të ndryshojë? Sipas formës së pagave në rreshtin e parë do të jetë kryetari i Gjykatës së Lartë, në rreshtin e dytë do të jenë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, në rreshtin e tretë do të jenë kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, kryetari i Apelit Administrativ, si dhe të gjithë gjyqtarët e tjerë. Gjithashtu, nëse do të ketë shkallë bosh, do të rreshtohen Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministrat dhe më pas të gjithë deputetët.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, nuk është në rregull! Nuk e ke reflektuar siç duhet këtë pjesë, sepse ka edhe funksionarë të tjerë, që e kanë pagën më të lartë se kryetari i Gjykatës së Lartë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ju lutem, a mund të mbarojë zoti Fino?

**Bashkim Fino** – Ju mund të qeshni dhe keni të drejtë të qeshni, sepse unë përmenda këta që janë këtu.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Te shkallët më poshtë kisha parasysh inspektorët e KLD-së që i vendos Presidenti, dhe që do të marrin dyfishin e rrogës; kam parasysh 5 komisionerët e Avokatit të Popullit, që i zgjedhim ne me votë, të cilët do të marrin 80% të pagës si Avokati i Popullit, dy herë më shumë se Presidenti. Gjithashtu, nuk dua të harroj të përmend KQZ-në dhe OJF-të e tjera. Unë nuk po flas për sekretarin e Federatës së Futbollit, se mund të më thoni pastaj që ka konflikt interesi.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë e thashë këtë për të bërë pak humor, por kjo është edhe për të qarë, edhe për të qeshur. Problemi është shumë i thjeshtë dhe ky problem duhet zgjidhur. Dikush që merret me financë mund të thotë se unë kam të drejtë dhe çfarë do të na gjejë neve nëse e ndërrojmë nenin 12 dhe pagën e Presidentit të Republikës ta bëjmë 5 milionë lekë. Mirëpo Ministria e Financave nuk e thotë dot këtë gjë, mund të ta thotë ty, që je jurist, por nuk ma thotë dot mua, sepse në momentin që e vendos pagën e Presidentit 5 milionë lekë, del një problem shumë i madh dhe efekti domino është i jashtëzakonshëm. Pra, nëse do ta ndryshojmë pagën e Presidentit, atëherë do t'ia ndryshojmë edhe Kryeministrit, edhe Kryetarit të Kuvendit, si dhe të gjithë hierarkisë, në mënyrë që të respektohet protokollin që thashë unë. A e kuptoni që të gjithë këta që lexova këtu do të vijnë pas teje, zoti Ulsi?! Pra, që të vijnë pas teje, do të thotë se duhet ndryshuar kjo gjë dhe që të ndryshohet kjo, ndryshohet i gjithë sistemi i pagave dhe kështu me radhë. Pra, jua thashë këto pak sa për të hapur oreksin, por do t'ju them më shumë në diskutimin tim në parlament.

Unë ju respektoj dhe ju dua shumë, por kini mirësinë të më dëgjoni 10 minuta në sallën e parlamentit, kur të flas për ndryshimin e pagave, sepse do të dëgjoni xhevahire të jashtëzakonshme, të cilat nuk i di as qeveria vetë se si i shpërndan dhe se si e jep fondin e pagave. Pra, dua të bëj një vërejtje sugjeruese komisionit për nenin 12, sepse është një nen që nuk përputhet me këto shifra që ne miratuar, me kontigjencën që kemi e të tjerë me radhë. Ne ecim me dy standarde: në standardin e parë themi se paga e Presidentit është maja e piramidës dhe pjesa tjetër, ligje dhe aktet normative të caktuara, që kemi miratuar, kanë kaluar me fond page tjetër. Kjo do të thotë se ato nuk janë në piramidën e pagave, sepse nëse ti më pyet se sa e dua rrogën ky është konflikt i pastër interesi dhe këtë gjë e ka bërë Gjykata Kushtetuese, por për mua dhe tani nuk ka më as Gjykatë Kushtetuese. Prandaj, unë kam vërejtje për punën e tyre dhe mendoj se Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të paraqesë një propozim për vendosjen e një hierarkie të pagave. Këtë propozim unë e bëj në mënyrë që qeveria ta ketë parasysh që në ligjin e buxhetit të shtetit të ngrejë një grup pune për të bërë një hierarki të re të pagave, dhe është e detyruar ta bëjë, në funksion të kësaj me këto ndryshime të pagave që janë bërë.

Kjo sjell edhe diçka tjetër që sa herë qeveria do të rrisë pagat, aq herë këta do të preken. Çfarë do të thotë kjo? Pse vetëm kjo kategori është e interesuar të marrë rrogat? Ne sapo thamë dhe e vlerësojmë këtë buxhet se ka rritur pagat e diplomatëve, ka rritur pagat e ushtarakëve, ka rritur pagat e arsimtarëve, të infermierëve, të doktorëve, sepse vërtet i kishin pagat e ulëta. Pra, dua të përgëzoj qeverinë që ka mundur rritjen e këtyre pagave dhe e përgëzoj qeverinë “Rama”

që ka ulur numrin e punonjësve nga 110 mijë, në 82 mijë që është sot. Pra, e ka ulur numrin e punonjësve me 22 mijë veta dhe ka bërë mirë, sepse ka bërë të mundur rritjen e pagave për këto kategori që përmenda më sipër. Pra, nëse ne do t'u rrisim pagat këtyre grupeve në nevojë, atëherë edhe këta të tjerët, që e kanë pagën e lartë, do të marrim përsëri rritje page?! Atëherë, çfarë do të bëhet me pjesën tjetër? Unë mendoj se Këshilli i Ministrave, me hyrjen në fuqi të ligjit të buxhetit të shtetit, automatikisht duhet të paraqesë një propozim për një rivendosje të re të hierarkisë së pagave.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Fino!

E hedhim në votim nenin 12, me sugjerimin e bërë nga kolegu Fino për Komisionin e Ekonomisë dhe për Këshillin e Ministrave lidhur me hierarkinë e sistemit të pagave në Republikën e Shqipërisë, që kanë si pagë reference pagën e Presidentit. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16, ka të bëjë me transfertën e pakushtëzuar.

Sigurisht, debati për këtë nen është bërë edhe nga kolegët Çuçi dhe Hyseni, por edhe me shpjegimin e kolegut Fino është shumë e nevojshme që ndoshta në kolonën e formulës së transfertës së pakushtëzuar ne t'i sugjerojmë komisionit përgjegjës, por edhe qeverisë, që në formulë të pasqyrohet ndoshta mundësia e pasjes në konsideratë të bashkive që janë në mbrojtje nga UNESCO, si dhe bashkitë e vijës bregdetare, pa cenuar atë që është dhënë deri tani me formulën ekzistuese.

**Bledar Çuçi** - Dua ta përmend edhe një herë këtë gjë, sepse e kam me merak dhe jam në mbrojtje të formulës. Nuk duhet të preket formula, por duhet të shtohet një kolonë në tabelën nr. 3.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo duhet të vendoset dhe të bëhet e qartë në buxhetin e shtetit, që kjo transfertë e pakushtëzuar do të jetë e destinuar për dy bashkitë që janë në mbrojtje nga UNESCO. Pra, nuk duhet t'ia çojë Ministrisë së Kulturës, që më pas ajo ta ndajë sipas oreksit të saj. Ministria e Kulturës, në një moment mund të mos ketë asnjë interes për t'i financuar, por është detyrimi i buxhetit të shtetit t'i garantojë aty shërbimet. Kjo duhet të bëhet në një kolonë specifike, ashtu siç jeni shprehur edhe ju, sepse...

**Fran Brahimi** – Ku do t'i gjejmë paratë ne?

**Bledar Çuçi** – Paratë gjejini ku të doni, sepse kur keni paraqitur këtu buxhetin e shtetit e keni pasqyruar në relacion që do të jetë tek tabela nr. 3, por nuk e keni vendosur tabelën nr. 3. Atë po të kërkoj unë, atë që ke thënë në relacion. Ti e ke thënë vetë në relacion: do të jetë në tabelën 3, jashtë formulës. Jam shumë dakord. Por duhet të jetë në tabelën 3, e destinuar për dy bashkitë që janë në UNESCO.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 16, me sugjerimet e bëra nga kolegët?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 17.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 18.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 19.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 20.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 21.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 22.

**Spartak Braho** – Këtu do të vihet shtesa që bëri Bashkimi.

**Ulsi Manja** – Zoti Fino.

Ju lutem, ndizeni mikrofonin!

**Bashkim Fino** – Unë e lidha me nenin 12, por natyrisht, te neni 22 mund të vihet shtesa, që: Këshilli i Ministrave, brenda tre muajve apo gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e projektligjit, paraqet propozimin për vendosjen e hierarkisë së pagave në administratën publike, në Republikën e Shqipërisë.

**Ulsi Manja** – A mund ta bëjmë këtë shtesë në projektligjin e buxhetit?

**Bashkim Fino** – Pse të mos e bëjmë?

**Ulsi Manja** – E bëjmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, jam dakord! Ju lutem, formulojeni, që ta hedhim në votim edhe këtë.

**Bashkim Fino** – E formulova.

**Ulsi Manja** – Formulimin ta reflektojmë te neni 22.

Kush është dakord me nenin 22, me propozimin e kolegut Fino?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Neni 23 ka të bëjë me hyrjen në fuqi.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Tani, përpara se ta hedhim për votim në tërësi projektligjin “Për buxhetin e shtetit”, është shumë e rëndësishme të jetë i qartë për opinionin publik, dhe këtë e kam konstatim të këtyre dy tre ditëve të fundit, shtimi i numrit të punonjësve në shkallë republike.

Gjatë këtyre dy-tre ditëve kam dëgjuar shifra që qeveria, në këto pesë vitet e fundit, ka shtuar numrin e punonjësve në administratën publike. Madje kam dëgjuar shifra 140 mijë, 160 mijë pardje, në një aktivitet që zhvillonte shoqëria civile. Është shumë e rëndësishme të evidentohet ky fakt.

Në 2013-ën, kur ne e kemi marrë qeverisjen, kanë qenë 110 mijë punonjës, sipas buxhetit të atij viti. Sot, me nenin 11, ne votojmë 82 mijë e 22 punonjës, nëse do të reflektohen edhe ato

shtesa, të cilat sapo i miratoi Komisioni i Ligjeve, për Komisionin e Ekonomisë, që shkon diku te 10-15 punonjës. Pra, janë 82 mijë e 22, sipas nenit 112 të ligjit për buxhetin.

Duke pasur parasysh shifrën 110 mijë të 2013-ës, dhe shifrën 82 mijë e 22 të vitit 2019, nuk besoj se numri i punonjësve të administratës publike ka ardhur në rritje. Përkundrazi, ka ardhur në zbritje, dhe ky është premtim i mbajtur i kësaj qeverie.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është shumë e rëndësishme që kjo të bëhet e qartë për opinionin publik. Zoti Fino e ka theksuar disa herë gjatë diskutimit në parim dhe nen për nen, po përpara votimit në tërësi e pashë të nevojshme ta jepja këtë sqarim për opinionin publik.

Atëherë hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

Kush është dakord në tërësi?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për buxhetin e shtetit për vitin 2019”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Illir Sallaku – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë



**Ulsi Manja** – Kalojmë në pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës, që është shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Kalojmë te neni 1.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është projektligji për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.

Neni 2.

Po.

**Bashkim Fino** – Në këtë nen, ashtu si në të gjitha nenet e projektligjit, të mos citohen titujt e neneve që ndryshojnë, pasi është e panevojshme sa i takon teknikës legjislative. Në këtë nen të bëhet korrigjimi dhe saktësimi sipas togfjalëshit të zëvendësuar. Është këshilli i bashkisë, jo bashkia.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Aktualisht, te ligji që është në fuqi, në nenin 5 thuhet: “Me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe...”. Është cituar vetëm emri: bashkisë. Duhet të jetë këshilli i bashkisë. Në rregull. dakord!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – E para, nuk shkon fraza: bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Që t’i marrim me radhë sugjerimet në lidhje me nenin 2.

Zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Tani, ky është diskutim i kotë, sepse ka një ligj të tërë, që ndan kompetencat, pra çfarë është kompetencë e kryetarit e çfarë është kompetencë e këshillit bashkiak. Kur thua “bashkia” ke thënë institucioni, dhe brenda bashkisë është ligji “Për vetëqeverisjen vendore” ai që i ndan kompetencat. Kësisoj, ne do të ruajmë termin bashkia, e pastaj i referohemi legjislacionit përkatës, se ku është kompetenca e këshillit, ku është kompetenca e kryetarit, e kështu me radhë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Po, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Në kuptimin juridik ka të drejtë Çuçi. Në kuptimin praktik mund të dalin probleme sa i takon zbatimin në terren, kur kryetari i bashkisë thotë: ma ka dhënë ligji i buxhetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bledar Çuçi** – Bashkia s’është kryetari i bashkisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Kush është bashkia?

**Bledar Çuçi** – Bashkia është institucion.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Pse të mos e themi direkt?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po flasim për çështjen e taksave vendore.

**Bledar Çuçi** – E ka ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bledar Çuçi** – Për taksat vendore e ka këshilli bashkiak.

**Alket Hyseni** – Po pse të mos e themi direkt, pra?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Të ndjekim linjën e relatorit njëherë.

Zoti Fino, po e ndjek ligjin “Për sistemin e taksave vendore”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I ka ligji për pushtetin vendor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është dakord me nenin 2, me sugjerimet e bëra nga zoti Çuçi?

Pro? Kundër. Abstenim s’ka.

Miratohet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – E bëtë pyetjen? Doni përgjigje?

Zoti Fino, që t’ju sqaroj, por besoj edhe t’ju iluminoj, ashtu siç mendoj unë: detyra jonë është të bëjmë ligje të qarta e të sakta. Ligje të qarta e të sakta janë ato ligje, të cilat, gjatë zbatimit të tyre në praktikë nuk sjellin konfuzion. Në gjykimin tim, një korigjim i termave: nga bashkitë,

në këshillat bashkiakë, sillte një implementim të saktë të ligjit. Tani jemi te ligji “Për taksat vendore”, zotërinj. Ne po diskutojmë një ligj specifik, ligjin “Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë”. Duke qenë se kompetente për vendosjen e taksave në pushtetin lokal është këshilli bashkiak, i përcaktuar me ligj, cila është arsyeja që të mos themi direkt se cili organ është, por të bëjmë sofizma, duke thënë: bashkitë. Është sofizëm ai.

**Bledar Çuçi** – S’është sofizëm.

**Alket Hyseni** – Më lejo të them mendimin tim. Ai është mendimi juaj. Meqenëse relatori kërkonte shpjegimin e votës, po e bëj. Unë mendoj: doni të jeni juristë? Juristët flasin me terma konkretë, e jo t’ia lënë për interpretim një organi atje, që nesër, një i papërgjegjshëm të thotë: nuk e ka këshilli bashkiak, por bashkia.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Çuçi, zoti Fino, a ka mundësi të mbarojë zoti Hyseni?

**Alket Hyseni** – Detyra jonë është që kur t’u referohemi ligjeve të tjera, t’i respektojmë këtu. Tani, nëse ligjet e tjera thonë se organi për taksat vendore është këshilli bashkiak, pse duhet ta lëmë të përgjithshëm e të mos e themi konkretisht?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, unë thashë: nga pikëpamja juridike mund të vlejë edhe po të themi bashkitë, por unë doja që të ishim më konkretë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë këtë kërkova të mbështes.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, zoti Hyseni, ju lutem, a ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është e thjeshtë gjëja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Jemi me të njëjtën gjatësi vale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – E ka Kushtetuta. Taksa vendore është e këshillit bashkiak. Nuk e vendos njeri tjetër. Edhe në referencë të ligjit, siç thotë përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, vendos këshilli bashkiak. Jo pa qëllim e kemi vënë këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si këshilli bashkiak, ashtu edhe bashkia, është pothuajse e njëjta.

**Ulsi Manja** – Debati është shumë i shëndetshëm nga pikëpamja juridike, por në hierarkinë e normës, këtë e ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligji “Për pushtetin vendor”, që janë votuar me 84 vota. Dakord?

Neni 3.

Pro? Kundër. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Neni 4.

**Bashkim Fino** – Sqarimi që bëmë me ministrin e Financave. Domethënë, ideja ishte: më përpara pensionistët nuk paguanin taksë për ndërtesën, por me riformulimin që është bërë tani, gjatë diskutimit në parim me ministrin dilte sikur një pensionist që jeton i vetëm nuk do të paguajë taksë, ndërsa dy pensionistë, burrë e grua, i binte sikur do të paguanin taksë, ndërkohë që ligji i mëparshëm e kishte që nuk do të paguanin. Sipas sqarimit që na bëri ministri, është që jo, absolutisht. Ashtu siç ka qenë në ligjin e mëparshëm, që pensionistët, kur janë burrë e grua, apo njëri prej tyre i vetëm, nuk do të paguajnë taksë shtëpie. Riformulimi që ne kemi bërë, për të qenë sa më të qetë ne, zoti kryetar, sepse na e pranoi vetë ministri i Financave këtu, para një jave, është ky: “Ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie, pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose edhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë.”

Pra, është germa “ë” e riformuluar kështu, për të mos na krijuar ekuivok as në rastin e pensionistëve kur janë burrë e grua, as në rastin kur është një pensionist i vetëm, të cilët nuk do ta paguajnë taksën mbi ndërtesën.

Ky është ndryshimi që duam të bëjmë, me qëllim që ta saktësojmë. Ministri na e tha me gojë, por ne duam të jemi korrekt me ndryshimin që bëmë.

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky ishte edhe shqetësimi im, kështu që e falënderoj zotin Fino, i cili e ka diskutuar dhe adresuar. ndërkohë, unë kam një pyetje për propozuesit.

Prej disa kohësh janë diskutuar në këtë komision rastet kur organizata ofrojnë shërbime sociale, pra bashkitë ofrojnë shërbime sociale për njerëzit në nevojë. Ata janë të detyruar të paguajnë taksën e ndërtesës, ndërkohë që shërbimet që ofrojnë për paraplegjikët, tetraplegjikët,

fëmijët autikë, fëmijët me sindromën Down, si dhe për shumë kategori të tjera, janë shërbime nga të cilat nuk nxjerrin të ardhura, nuk nxjerrin përfitime. Nuk e di se sa është adresuar ky shqetësim në këtë projektligj. E para kjo.

E dyta. E bëj këtë pyetje pasi ndërkohë që ju po flisnit kontrollova të gjitha ligjet në fuqi për taksën vendore dhe ndryshimet. Nuk kemi një variant të konsoliduar të ligjit, që të kuptojmë se ku ndërhyhet, çfarë sjell ndërhyrja, dhe çfarë ndryshon ajo. Pra, është shumë e paqartë. Për të mos thënë më pas, se relacioni që shoqëron këtë projektligj nuk e bën të qartë çfarë takse ulet e çfarë takse ngrihet.

Në rastin konkret, në qoftë se i referohemi relacionit, thuhet vetëm se në nenin 4 parashikohen riformulime të pikës 6 të nenit 22. Unë këtë e shikoj, sepse në pikën 6 të nenit 22: “Taksa mbi ndërtesën” bëhen këto ndryshime.

Mua, si ligjvënëse, më intereson të di se cila është politika. Çfarë po bëhet? Çfarë po ndryshon? Si po ndryshon? Kush përfiton?

Nëse ne vazhdojmë me këto lloj formulimesh, kur merret *copy pastë* koka e çdo neni që amendohet, ky nuk është relacion dhe nuk i shërben as krijimit të bindjes sonë të brendshme, as transparencës me publikun.

Unë do të doja përgjigje për pyetjen e parë, ndërsa këtë e kisha si sugjerim për vijimësinë, meqenëse duhet t’ia adresojmë konkretisht edhe Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka pyetje të tjera në lidhje me nenin 4? Nuk ka.

Ministria e Financave.

Ky problem që ngriti kolegja Hysi nuk është vetëm për këtë projektligj. Në dinamikë ne e kemi ngritur se projektligjet që vijnë për të ndryshuar nene të caktuara të ligjeve ekzistuese që janë në fuqi, duhet të shoqërohen edhe me relacion të qartë shpjegues, se cila është arsyeja që kërkohet të ndryshohen, dhe sigurisht do të duhet të kemi edhe një tekst integral të ligjit. Kjo vlen edhe për këshilltarët tanë. Ne duhet të kishim këtu ligjin e plotë “Për sistemin e taksave vendore në RSH”, për të parë se çfarë synojnë ndryshimet që sjell Ministria e Financave me këtë paketë.

Këtu thuhet se neni 4 ndryshon pikën 6, të nenit 22 për taksat mbi ndërtesat, por se çfarë thotë pika 6, e nenit 22 të ligjit në fuqi, ne nuk e kemi, për të pasur një gjykim, një diskutim të shëndetshëm dhe një panoramë të plotë në këtë komision.

Gjithsesi, duke besuar që zoti Fino e ka parë me vëmendjen që kërkon ky projektligj, e hedhim në votim nenin 4 me riformulimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zoti Hyseni për të bërë një propozim!

**Alket Hyseni** – Unë propozoj të hiqen fjalët që shtohen këtu: “personat në ngarkim të tyre, të paaftë për punë”. Duhet të kuptojmë se në ngarkim të pensionistëve ka vetëm persona, që janë të paaftë për punë. Pra, nuk kemi pse të përdorim një kuptim të tillë, kur nuk mund të ketë në ngarkim të pensionistëve persona që janë të aftë për punë. Në asnjë ligj nuk është kjo.

**Ulsi Manja** – Po ta heqim këtë, pastaj mund të të keqinterpretohet ky ligj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Unë kam një merak: të paaftë për punë janë të gjithë ata që janë në ngarkim të pensionistëve, si fëmijët e mitur, personat me aftësi të kufizuara. Pra, nuk janë në ngarkim të pensionistëve persona të aftë për punë. Asnjë ligj nuk lë në ngarkim të pensionistëve persona që janë të aftë për punë. Bëhen ca formulime që nuk janë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kam këtë merak zoti Fino: a mund të fusim që të mbrojmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ministria e Financave do të mbrojë një kategori të gjerë, siç janë pensionistët, që jetojnë vetëm dhe kanë të ardhura të kufizuara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Qëllimi i kësaj norme, zoti Shamenti, është që një kategori e gjerë, siç janë pensionistët që jetojnë vetëm dhe kanë të ardhura të kufizuara, të mbrohen nga pagesa e taksës.

Po pensionistët që janë biznesmenë, a mund t'i fusim në këtë kategori?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, i vetmi përjashtim që mund të bëjmë këtu është të shtojmë: përveçse kur nuk kanë të ardhura nga biznesi e të ardhura të tjera, por jo kur janë në ngarkim të pensionistëve persona të paaftë për punë, sepse në ngarkim të pensionistëve ka vetëm persona, që janë të paaftë për punë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Djali nuk është në ngarkim të pensionistit, kur është mbi 18 vjeç.

**Ulsi Manja** – Është shumë e saktë.

**Alket Hyseni** – Megjithatë, ky nuk është problem. Unë kam një tjetër merak.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Çuçi!

**Bledar Çuçi** – Kolegu Hyseni ka të drejtë, kur thotë se neni ka nevojë për një rregullim. Qëllimi i Ministrisë së Financave është i drejtë. Ajo thotë se do të përjashtojë vetëm pensionistët që jetojnë vetëm. Ky është qëllimi final, por formulimi thotë se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e thotë të gjithën, sepse sipas variantit të shkruar nga ju, thuhet se një pensionist që banon së bashku me të birin, i cili punon dhe merr 3 milionë lekë në muaj, është i përjashtuar nga taksat. Në fakt nuk realizohet qëllimi, sepse qëllimi është të favorizohen vetëm pensionistët që nuk kanë të ardhura dhe nuk jetojnë me fëmijë që kanë të ardhura. Ky është qëllimi. Formulimi nuk e kënaq këtë qëllim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Duhet rregulluar formulimi për të realizuar qëllimin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas asaj që komentoj zoti Hyseni, nuk është ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Hyseni, të nisemi nga formulimi i dispozitës ekzistuese, që propozohet dhe nëse ka nevojë për riformulim, dakord, por ne po bëjmë debat dhe nuk ka asnjë formulim konkret.

Dispozita thotë: “Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;”

Unë kam një pyetje: Çfarë nënkuptojmë me fjalët “persona të paaftë për punë”?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E ka ligji? Bukur!

Ju, si Ministri e Financave, a mendoni se dispozita e zgjidh qëllimin? Pra, a është në përputhje me qëllimin që ju propozoni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Fran Brahimi** – Ne këtu jemi përpjekur për të përfshirë ato kategori që thatë ju, pra kategorinë e pensionistëve që nuk kanë të ardhura nga burime të tjera, pra përveç pensionit dhe pensionit social. Njëkohësisht, kur këta kanë në varësi edhe persona, të cilët aktualisht janë të paaftë për punë, si tetrapelgjikët, fëmijët, etj. për shkak se mund t’u kenë vdekur prindërit apo për arsye nga më të ndryshmet. Personat që janë në këto kushte duhet të përjashtohen nga taksa.

**Ulsi Manja** – Shumë dakord!

Atëherë, unë mendoj se ka nevojë të shtohet në dispozitë vetëm fjala “ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljari që përfiton vetëm pension pleqërie, pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;

Fjala “vetëm” nënkupton që nuk ka asnjë burim tjetër të ardhurash.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjala “vetëm”, nëse kolegët janë dakord me mua, besoj se e zgjidh problemin. Kjo fjalë thotë që është vetëm për një kategori pensionistësh, që kanë si burim të ardhurash vetëm pensionin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord?

Zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Po të lexosh dispozitën që keni përpara, ne e diskutuam me ministrin dhe na u duk jo e saktë fjala: “Pensionistë të vetëm”. Kjo na e vrau syrin dhe pyetëm se si është në ligjin ekzistues. Na u përgjigjën se nuk është vendosur taksë për pensionistët.

Atëherë, pyetëm pse është vendosur termi “pensionistë të vetëm”? Këtu presupozohet që kur janë burra dhe grua, duhet të paguajnë, ndërsa kur njëri ka vdekur dhe jeton vetëm njëri, nuk paguajnë.

Ministri na dha fjalën që kjo pikë do të qëndrojë siç është. Riformulimi që unë lexova ka të bëjë vetëm me këtë ndryshim. Nga fjala “pensionistë të vetëm”, të bëhet “pensionistët në përgjithësi”, qofshin dy, qoftë një.

Sqarimi që bëre ti për rregullimin e nenit, është thellë mbi bisht. Duhet të jemi dakord edhe me këtë riformulim. Bëhet fjalë për pensionistët në tërësi dhe jo pensionistët e vetëm.

**Ulsi Manja** – Atëherë, Kush është dakord me nenin 4, me sugjerimin e kolegut Fino dhe me shtesën që unë propozova?



Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, ç'mendim keni për nenin 7?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Zoti kryetar,

Zoti relator,

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë e kërkoja fjalën qëkur po diskutohej neni 6.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 6 dhe neni 7 kanë referenca në anekset përkatëse. Kur ishte ministri herën tjetër, e diskutuam dhe i kërkoja ministrit, nëse mund të ketë një korigjim të referencat lidhur me klasifikimin e bashkive.

Kishte një klasifikim të tokës, që është shkencor dhe merret nga Ministria e Bujqësisë. Jemi dakord me të, se nuk jam ekspert i fushës, por për klasifikimin e bashkive, kërkoja një sqarim,

duke marrë për shembull aneksin 1 për truallin. Delvina futet në kategorinë e dytë nga 4 që janë, duke u barazvlerësuar me Shkodrën, Elbasanin, Korçën etj., ndërkohë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti kryetar,

Është e pamundur. A do të dëgjojmë se këto janë gjëra të rëndësishme?

Kjo është përgjegjësia juaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Kjo reflektohet për të gjithë. Edhe ju flisni, kur flasin të tjerët.

**Alket Hyseni** – E ke konkrete. Unë po them ujku, ti më thua gjurmët.

**Ulsi Manja** – Të lutem tani!

**Alket Hyseni** – Ose ndërprite mbledhjen fare për 5 minuta.

**Ulsi Manja** – Nuk e ndërpres mbledhjen. Mbaro mendimin!

**Alket Hyseni** – Kjo është shumë e rëndësishme.

**Ulsi Manja** – Rëndësinë e vlerësojnë kolegët me votë.

**Alket Hyseni** – Unë po kërkoj minimumin e etikës. Se si e vlerësojnë me votë, është çështje tjetër.

**Ulsi Manja** – Nuk mund të më kërkosh mua llogari dhe të më kërkosh të mbaj qetësi.

**Alket Hyseni** – Patjetër, se je kryetar.

Nëse nuk ta kërkoj ty, kujt t'ia kërkoj unë?

**Ulsi Manja** – Mbaro mendimin!

**Alket Hyseni** – Nëse nuk e bën dot, të kërkoj llogari.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Delvina nuk mund të futet në kategorinë e dytë të rretheve dhe ramë dakord me ministrin që kjo do të shihet. Unë nuk e kam vetëm për Delvinën. Thashë ta shohin me kujdes kur t'i kategorizojnë, sepse që një banor në një bashki shumë të varfër, të ketë një barrë takse për truallin më të lartë se në një bashki tjetër, nuk besoj se jemi *fair*. Në këtë sens, a mund ta lëmë të hapur çështjen e klasifikimit të bashkive?

A do të bëhet para se të shkojë te Komisioni i Ekonomisë, apo do të ndërhyjmë direkt sot me propozimet tona? Mendoj se edhe ne nuk jemi kompetentë për t'i thënë të gjitha. Unë mbaj përgjegjësi, sepse e di se çfarë niveli varfërie, dhe çfarë papunësie ka Delvina dhe çfarë mundësi kanë delvinjotët për të paguar taksat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal Bashkim!

E njëjta gjë është edhe te neni 6, edhe te neni 7.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Të lutem një sekondë, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Patjetër.

**Ulsi Manja** – Asnjëri nga deputetët nuk do ta marrë fjalën pa u shprehur relatori nen për nen. Askush mos ta ngrejë dorën, se nuk do ta marrë fjalën. Kjo vlen edhe për ty, zoti Fino.

Je relator i projektligjit dhe të takon të shprehesh nen për nen dhe më pas mund të shprehen deputetët.

Keni fjalën lidhur me këtë që tha kolegu Hyseni!

**Bashkim Fino** – Lidhur me këtë që tha kolegu Hyseni, është e vërtetë. Është diskutuar në parim dhe kemi rënë dakord me ministrin. Ai ka shprehur mendimin që çështja në fjalë është një çështje do të diskutohet më vete. Para se të kalojë nen për nen në Komisionin e Ekonomisë, ministri me ekspertët përkatës do të rishikojnë edhe një herë kategoritë e bashkive, duke e marrë në konsideratë atë që zoti Hyseni e tha para disa ditësh, por që e përsëriti edhe sot.

Për një gjë që e ka marrë përsipër ta rishikojë ministri me ekspertët, unë nuk kam se çfarë ndryshimi t'u bëj 2 neneve përkatëse, sepse është çështje e aneksit 1. Në këtë aneks kam bindjen se do ta zgjidhim duke parë mundësinë e zëvendësimit të kategorive. Heqja e një bashkie, apo një qyteti nga një kategori në një tjetër, është çështje e Ministrisë së Financave. Vendimi do t'i bashkëngjitet me një shënim projektligjit dhe problemi është i zgjidhur.

Nuk mundet që ne të botojmë 67 mijë çështje. E vetmja gjë që kërkon zoti Hyseni apo mund të kërkoj edhe unë, është kategorizimi sipas dosjeve. A do të jetë Delvina në kategorinë 2 apo do të jetë në kategorinë 3? Ndoshta mund të jetë në kategorinë 3. Atëherë ai mund ta fusë në pasqyrë dhe problemi është i zgjidhur. Nuk ka pse të ndryshojnë nenet 6 dhe 7, por ndryshon vetëm kategorizimi.

Ai këtë po kërkon dhe është në rregull me këtë kërkesë. Këtë gjë e mori përsipër ta zgjidhë ministri rast pas rasti. Unë nuk mund ta them dot tani, sepse këtë e ka marrë në dorë ministri për ta zgjidhur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj t'i kalojmë nenet 6 dhe 7 kështu siç janë dhe t'i kërkojmë ministrit të Financave ta zgjidhë rastin konkret që ngriti deputeti.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Dakord.

Edhe unë bashkohem me mendimin e relatorit për shqetësimin që ngriti kolegu Hyseni.

Kalojmë te neni 7, duke bërë edhe sugjerimin që sapo diskutuam.

Kush është pro me nenin 7 me sugjerimet e kolegut Fino dhe të kolegut Hyseni?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, shprehuni me mikrofon për këtë nen, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Është në rregull, s'ka probleme.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Kush është dakord me nenin 8?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9.

**Bashkim Fino** – Te neni 9 kam vetëm një problem në fund fare të paragrafit të tretë, ku thuhet: “Sipas përcaktimeve të nxjerra me akte të Këshillit të Ministrave”. Cilat janë këto akte? Do të jenë udhëzime apo vendime? Bëhet fjalë për bazën e taksës, vlerën në lekë për m<sup>2</sup>, çmimin e shitjes së ndërtimit etj.

“Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.”

Mund të mbetet edhe kështu, por mund të bëhet sipas përcaktimeve të nxjerra me udhëzim apo me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Këtu është vënë e përgjithshme: “akt i KM-së”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e specifikon dot. E ka zëvendësuar fjalën “udhëzim” me fjalën “akt”.

A lejohet të quhet akt? Ka qenë “udhëzim” më parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull. E vetmja gjë që vënë re këshilltarët, është se në ligjin e mëparshëm ka qenë udhëzim. Tani e kanë zëvendësuar fjalën “udhëzim” me fjalën “akt”.

Pra, mund ta nxjerrin me udhëzim, por mund ta nxjerrin edhe me VKM.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me nenin 9 me këtë sugjerim?

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10.

Ju lutem, shprehuni me mikrofon, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Është në rregull. Nuk kam asnjë ndryshim për të.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Kush është pro me nenin 10?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11.

**Bashkim Fino** – Është në rregull. Nuk kam asnjë ndryshim.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Kush është pro me nenin 11?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

**Bashkim Fino** – Është në rregull.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Kush është pro me nenin 12?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Neni 13.**

**Bashkim Fino** – Nuk kemi asnjë vërejtje.

**Ulsi Manja** – Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14.

**Bashkim Fino** – Nuk kemi asnjë vërejtje.

**Ulsi Manja** – Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15.

**Bashkim Fino** – Nuk kemi asnjë vërejtje.

**Ulsi Manja** – Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16, hyrja në fuqi.

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 16.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 96/32, datë 30.10.2006 ,“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””, me sugjerimet që bënë kolegët për nene të caktuara.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 96/32, datë 30.10.2006 , “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””.

Sjell në vëmendjen e relatorit, por edhe të këshilltarëve të komisionit që të dyja projektligjet, së bashku me relacionet përkatëse dhe sugjerimet që janë bërë për to, t’ia përcjellim komisionit përgjegjës, Komisionit të Ekonomisë.

Unë, së bashku me relatorin, zotin Fino, do ta mbrojmë edhe te komisioni përgjegjës këtë projektligj që sapo miratuam në komision.

Me këtë çështje mbyllet edhe mbledhja e Komisionit të Ligjeve për sot.

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Dua të falënderoj të gjithë kolegët e mi deputetë për durimin dhe përkushtimin në miratimin e këtyre ligjeve shumë të rëndësishme për një parlament dhe një komision!

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj relatorin, kolegun tonë, Bashkim Fino, për përkushtimin, durimin dhe sugjerimet e vyera për Komisionin e Ekonomisë!

Besoj se të gjitha institucionet duhet të jenë të kënaqura që erdhën dhe u dëgjuan në këtë komision.

Kam një falënderim edhe për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, posaçërisht për zonjën Dhëmbi, zotin Brahimi dhe zotin Sallaku.

Zoti Fino, nëse do të thuash diçka, përpara se ta mbyllim mbledhjen...

**Bashkim Fino** – Komision më i mirë dhe më i dëgjueshëm nuk bëhet. E miratuat me shpejtësi dhe kontribuat për buxhetin e vitit 2019. Ishte një buxhet vërtet shumë i mirë.

Ju falënderoj për kohën që harxhuat, si dhe për faktin se si asnjë herë tjetër buxheti nuk ka kaluar kaq shpejt!

Në emër të Çuçit, dua t'ju jap nga një kafe dhe nga një ujë, meqë e mbaruam edhe buxhetin.

**Ulsi Manja** – Faleminderit edhe një herë!

Edhe 100, zotit Çuçi!

Zoti Çuçi do ta mbajë mend gjatë këtë datëlindje, sepse ka koinciduar me datën e miratimit të buxhetit të vitit 2019.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

